

**VENDIM**  
**Nr.646, datë 12.11.2007**

**PËR MOSDHËNIE LICENCE PËR RADION PRIVATE VENDORE**  
**“RADIO PRO ALBANIA”**

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Mbi procedurat e licencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

**VENDOSI:**

1. Të mos licencojë për transmetim radiofonik privat vendor subjektin “Pro Radio Albania” sh.p.k., pasi në dokumentacionin e paraqitur mungon:
  - a) deklarata e vërtetësisë së të dhënave.
2. Subjekti, mund të ankohe në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Tiranë, në përputhje me Kodin e Procedurës Civile, kreu “Gjykimi i mosmarrëveshjeve administrative”.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARE**  
**Mesila Doda (Demi)**